

UDHËZIM
Nr.13, datë 27.6.2011

**PËR MËNYRËN E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE, KRYERJEN E ANALIZAVE TË
TOKËS DHE PËRCAKTIMIN E DISA PROCEDURAVE PËR NDRYSHIMIN E
KATEGORISË SË TOKËS BUJQËSORE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të pikës 7 të kreut V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.121, datë 17.2.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki”,

UDHËZOJ:

I. Shqyrtimi i kërkesave për ndryshim të kategorive të tokës, sipas bonitetit, nga struktura përgjegjëse e administrimit të tokave në ministri bëhet si më poshtë:

1. Kërkesat e paraqitura në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) për ndryshim të kategorive të tokës, sipas bonitetit, nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës (DAMT) në qarqe, shqyrtohen nga struktura e saj përgjegjëse e administrimit të tokave.

2. Krite bazë të shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave të paraqitura për ndryshim të kategorisë së tokës, sipas bonitetit, janë detyrimet e përcaktuara në pikën 1 deri në 6 të kreut V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.121, datë 17.2.2011.

Në rastin kur vlerësohet se këto krite:

a) janë përmbushur plotësisht, miratohet ndërmarrja e procedurave për kryerjen e analizave të tokës dhe nxjerrjen e rezultateve;

b) nuk janë përmbushur plotësisht për një ose më shumë nga përcaktimet në vendimin e Këshillit të Ministrave të sipërcituar, njoftohet DAMT-ja e qarkut për mosmiratim të ndërmarrjes së procedurave për rikategorizim të tokës.

Kërkesa e pamiratuar ruhet në arkivin e MBUMK-së.

II. Kryerja e analizave të tokës për ndryshim të kategorisë së saj, sipas bonitetit, nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), Fushë-Krujë bëhet si më poshtë:

1. Struktura përgjegjëse e administrimit të tokave në MBUMK dërgon pranë QTTB-së Fushë-Krujë një kopje të kërkesës së miratuar për kryerjen e analizave të tokës për ndryshim kategorie, si dhe të dokumentacionit përkatës, me qëllim kryerjen e analizave të tokës dhe njofton për këtë DAMT-në e qarkut. Origjinali i kërkesës së paraqitur ruhet në MBUMK.

2. Drejtori i QTTB-së Fushë-Krujë, për kryerjen e analizave të tokës për ndryshim të kategorisë së saj, sipas bonitetit, krijon grupin e ekspertëve, me përbërje sipas përcaktimit të pikës 4, kreu III të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.655, datë 28.7.2010, duke siguruar detyrimisht pjesëmarrjen në këtë grup edhe të një përfaqësuesi të DAMT-së, si dhe të përgjegjësit të zyrës së menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në komunë dhe/ose bashki, në juridiksion të së cilës ndodhet toka objekt i kërkesës.

3. Grupi i ekspertëve të QTTB-së Fushë-Krujë kryen punimet fushore në ngastrën objekt të kërkesës bazuar në metodikën-tip të studimit të bonitetit të tokave, të miratuar nga ish-Instituti i Studimit të Tokave.

4. Numri i profileve për vlerësimin e treguesve pedologjikë dhe numri i mostrave përfaqësuese, si dhe i mostrave ndihmëse për përcaktimin e treguesve agrokimikë të jetë sipas udhëzimit nr.17, datë 5.11.2010 “Për përcaktimin e numrit të profileve e mostrave për sipërfaqen e tokës që analizohet dhe vlerës së analizave të tokës” të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Grupi i ekspertëve në parcelën (pronësinë) objekt i kryerjes së analizave për ndryshim të kategorisë së tokës, sipas bonitetit, përgatit skemat e vendhapjes së profileve për vlerësimin e treguesve pedologjikë dhe të vendmarrjes së mostrave ndihmëse për krijimin e mostrës përfaqësuese

për vlerësimin e treguesve agrokimikë. Skemat përgatiten përkatësisht sipas lidhjes nr.1 dhe lidhjes nr.2 të këtij udhëzimi, dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Në skemat që përgatiten të paraqitet:

a) Forma gjeometrike reale e parcelës (pronësisë) në shkallën $1:1000$ ose 100 cm^2 në hartë baras (=) me 10000 m^2 në natyrë (terren). Në anën e majtë të skemës paraqitet kufiri koordinativ (V dhe L) i vendndodhjes së parcelës.

b) Pavarësisht nga forma gjeometrike e parcelës (pronësisë), nëpërmjet matjeve me saktësi, përcaktohet dhe shënohet në skemë diagonalja më e gjatë e saj. Matja e gjatësisë së diagonales fillon në hyrje të parcelës, pika "0", dhe mbaron në fund të saj, pika "N".

c) Vendhapja e profilit për vlerësimin e treguesve pedologjikë bëhet në mesin e diagonales më të gjatë, që matet dhe pasqyrohet me saktësi në skemë. Matja fillon nga pika "1" e saj. Vendhapja e profilit regjistrohet me sistemin e pozicionimit gjeografik (GPS), si dhe shënohen koordinatat (V dhe L) të marra nga GPS.

ç) Marrja e mostrave ndihmëse për krijimin e mostrës përfaqësuese, për vlerësimin e treguesve agrokimikë, dhe paraqitja në skemë, fillon në pikën "M₁" dhe vijon gjatë gjithë gjatësisë së diagonales, në distanca saktësisht të barabarta (D), marrja e mostrës së pikës M₂, M₃,.....deri në mostrën ndihmëse të fundit "M_n".

6. Materiali i marrë në parcelën (pronësinë), objekt i kërkesës për ndryshim të kategorisë së tokës, sipas bonitetit, dërgohet për analizë në laboratorin e QTTB-së. Kryerja e analizave në laborator bëhet sipas metodave mbi të cilën është kryer studimi i bonitetit të tokave në vendin tonë ose metodave të tjera ekuivalente.

7. QTTB-ja e Fushë-Krujës, brenda një muaji nga marrja e detyrës, kryen analizat dhe bazuar në të dhënat e tyre, bashkë me aktvlerësimet harton raportin teknik me rekomandimet përkatëse, të cilat, bashkë me skemat e paraqitura sipas pikës 5 dhe lidhjeve përkatëse të këtij udhëzimi i dërgohen MBUMK-së.

8. QTTB-ja ruan për një periudhë 12-mujore kampionet dhe mostrat e analizuara dhe rezultatet e tyre, si dhe ruan në aparatin e GPS-së të dhënat koordinative të vendhapjes së profilit.

III. Vlerësimi i treguesve të analizave të tokës për ndryshim të kategorisë së tokës, sipas bonitetit bëhet, si më poshtë:

1. Struktura përgjegjëse e administrimit të tokave në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin dhe rezultatet e pasqyruara në to, të ardhura nga QTTB-ja.

Kur kjo strukturë vlerëson se në këtë dokumentacion, detyrimet që rrjedhin nga VKM nr 121, datë 17.2.2011 si dhe rregullat edhe kriteret e përcaktuara në kreun II të këtij udhëzimi, janë zbatuar plotësisht, ajo i propozon ministrit miratimin e rikategorizimit të tokës, objekt të kërkesës së paraqitur.

Nëse detyrimet, rregullat dhe kriteret nuk janë zbatuar plotësisht, atëherë ajo i rikthen materialin QTTB-së me detyrën për rishikim të plotë ose të pjesshëm të procedurave apo analizave për vlerësimin e tokës.

2. Struktura përgjegjëse për administrimin e tokës në MBUMK mund të organizojë kontrolle për saktësinë e hapjes së profileve, marrjes së mostrave, analizave të treguesve të tokës dhe të evidentimit e të pasqyrimit të tyre. Në çdo rast, kur nga kontrollet evidentohen probleme, përcaktohen masat administrative dhe teknike përkatëse.

3. Urdhri i ministrit për rikategorizim të tokës i dërgohet DAMT-së së qarkut, e cila ua komunikon subjekteve që kanë bërë kërkesën, ZMMT-së në komunë dhe/ose bashki dhe i pasqyron ato në librin e bonitetit të tokës.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli